

FJALA E DEPUTETES MERITA BAKIU

E ENJTE 24 MARS 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar qytetarë,

Kruja është një nga qytetet shqiptare e përfshira në çdo hartë turistike. 300 mijë është numri i vizitorëve, që vijnë çdo vit në këtë qytet, nga ku 150 mijë vizitojnë dy muzetë. Megjithëse ofron kaq shumë potencial për turizmin dhe për promovimin e krenarisë dhe vlerave më të mira shqiptare, Kruja është një nga qytetet që është lënë në mëshirë të fatit. Nuk ka investime konkrete, që nxisin punësimin dhe i kthejnë vitalitetin e dikurshëm qytetit. Kruja sot ka nevojë për një turizëm cilësor; është qytet i vlerave, është qytet i mikpritjes, i traditës, i artizanatit dhe si i tillë duhet të trajtohet. Nuk ka jetë sportive dhe i vetmi sport në qytetin e Krujës është futbollit. Skuadra e Kastriotit, edhe pse është në kategorinë e parë, e kam ngritur këtë shqetësim edhe herët e tjera, nuk ka një stadium ku të zhvillojë ndeshje. Këndi sportiv, ku zhvillohen aktivitete sportive dhe kulturore, është i pashfrytëzueshëm.

Gjithashtu, nuk ka art dhe jetë kulturore, megjithëse është një qytet që i ka dhënë kaq shumë Shqipërisë dhe shqiptarëve, e shpreh me shumë keqardhje këtë! Kësaj panorame i shtohet edhe fakti se zyrat e shërbimit janë transferuar në Fushë-Krujë dhe kjo është mjaft sfiduese për çdo qytetar të Krujës, të cilit praktikisht i duhet të bëjë disa kilometra për të marrë qoftë një dokument të thjeshtë. Gjithashtu, rruga Krujë-Fushë-Krujë është një tjetër shqetësim për banorët e këtij qyteti, pasi është e amortizuar dhe paraqet vështirësi në qarkullim. Të gjitha këto e bëjnë Krujën sot një qytet me një jetë sociale të paralizuar. Me të gjithë këto shqetësime unë sjell një panoramë jo të mirë për qytetin e Krujës, por kam edhe një lajm të mirë dhe këtu gjej këtu rastin të përshëndes dhe të shpreh mirënjohjen time për ambasadat austriake dhe zvicerane për mbështetjen e projektit të sallës së koncerteve "Ramiz Kovaçi".

Në Krujë jemi përballë një transformimi demografik, të cilin nuk e ka njohur historia. Sot vihet re një rritje në përqindje e numrit të qytetarëve mbi 65- vjeçarë që jetojnë në këtë qytet dhe një ulje e numrit të fëmijëve dhe të rinjve. Kushtet e vështira ekonomike i detyrojnë familjet e reja të largohen nga Kruja, të emigrojnë ose të mos bëjnë plane për zgjerimin e familjeve të tyre. Sot, nëse ecën rrugëve të Krujës, që dikur gumëzhinin nga zërat e fëmijëve dhe të rinjve, nuk takon më asnjë. Por ka një zgjidhje që mund t'i rikthejë dinjitetin këtij qyteti, që është ndërtimi i rrugës Krujë-Tiranë, një projekt i bërë që në vitin 2008, por që ende qëndron i pluhurosur në sirtarët e ministrisë. Kjo rrugë do të shpëtonte qytetin, do të ndihmonte ekonominë e këtij qyteti dhe nuk do të kishim shpopullim të qytetit, gjithashtu, do të zhvillohej turizmi. Përveç kësaj do të shfrytëzoheshin pikat turistike, si mali i Krujës dhe Qafështama, që janë pasuritë kombëtare të vendit tonë.

Ndaj në emër të të gjithë banorëve të Krujës i bëj thirrje Kryeministrit dhe qeverisë që ta zbatojnë këtë projekt dhe të shpëtojnë Krujën, që mbart historinë e Shqipërisë. Në kuadër të kësaj dhe të hartës territoriale gjykoj se ndarja aktuale është e gabuar, e pastudiuar dhe me pëlqim të njëanshëm për

qëllime të dukshme favorizuese politike. Ndaj kërkoj dhe do të insistoj që të rishikohet edhe një herë ndarja territoriale, ku Kruja dhe Fushë Kruja të mos jenë më në një bashki të vetme. Sot ngjarjet e luftës në Ukrainë, mbase si për ironi, por janë edhe një kamberë alarmi, pasi nuk ka shqiptar që nuk mund të shohë apo të dëgjojë sa dëm po i bëni këtij vendi duke e neglizhuar bujqësinë dhe prodhimtarinë. Dhe këtë ma përforcojnë më shumë rrëfimet e bujqve në Krujë, të cilëve dëshira për të punuar dhe investuar në tokën e tyre u mungon, sepse prej vitesh përballen me pasojat e mungesës së orientimit, informacionit për tregjet dhe mungesën e subvencioneve nga ana e qeverisë, të cilat nuk shkojnë drejtpërdrejt te fermerët, por shkojnë më shumë në xhepat e punonjësve të shtetit.

Në zona të ndryshme ka problematika nga më paradoksalet, nga ato që ndoshta nuk kërkojnë as ndonjë investim të madh, por janë produkt i neglizhencës dhe i paaftësisë së atyre që drejtojnë. Kullimi dhe vaditja është problemi më i madh i zonës së Thumanës, gjithashtu, kontrolli i farërave dhe plehrave që hyjnë në vend është një pasiguri e madhe që rëndon në supet e fermerëve dhe më pas edhe na rrezikon të gjithëve ne si konsumatorë. Gjithashtu, kam ngritur problematikën e njësisë administrative të Currilës, e cila sot vuan tmerrësisht furnizimin me energji elektrike, në këtë njësi mungojnë shërbimet e nevojshme dhe të domosdoshme. Nuk është më shumë se 30 kilometër larg nga kryeqyteti dhe po të shkoni atje do të vini re se varfëria dhe skamja janë të dukshme. Ndaj kërkoj nga qeveria të tregojë vëmendje dhe kujdesje për qytetin e Krujës, sepse e meriton, sepse është kryeqyteti i parë shqiptar. Faleminderit!